



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Odiseja" Sh.P.K. të datës 10.06.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 05.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projektit kryesor për ndërtimin e nënkalimit (tunelit) automobilistik në kryqëzim të rrugëve Agim Ramadani dhe Ibrahim Lutfiu Prishtinë" me nr. të prokurimit 616-23-4309-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Odiseja" Sh.P.K. e datës 10.06.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 05.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projektit kryesor për ndërtimin e nënkalimit (tunelit) automobilistik në kryqëzim të rrugëve Agim Ramadani dhe Ibrahim Lutfiu Prishtinë" me nr. të prokurimit 616-23-4309-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Odiseja" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Odiseja" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 10.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 05.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projektit kryesor për ndërtimin e nënkalimit (tunelit) automobilistik në kryqëzim të rrugëve Agim Ramadani dhe Ibrahim Lutfiu Prishtinë" me nr. të prokurimit 616-23-4309-2-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: *“Ku ne kete procedure te tenderimit keni kerkuar nje arkeolog me pervoj 3vjeqare, Ne kemi kontaktuar me shume bashkepuntor te cilet merren me kete fushë dhe na kan informuar qe eshte konflikt i interesit angazhimi i tyre ne kete procedure pasi qe ne vet mbikqyrje do te jete ky institucion ne disa faza. Andaj nuk mund te angazhohen ne kete procedure pasi qe bie ndeshi me interesin qe do te jete. Shpresojme qe bazuar ne ligjin e prokurimit te shqyrtohet te largohet ky kriter pasi bie ndeshi me ligjet e lartecekura”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 65, 66 dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 20.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit: zyrtari përgjegjës i prokurimit me datë 19.06.2023 ka kërkuar nga njësia kërkuuese (e cila ka përcaktuar këtë kriter në DT) që të ofroj sqarime mbi pretendimet e parashtruesit në kërkesën për rishqyrtim. Me datë 20.06.2023 njësia kërkuuese ka ofruar sqarime e kërkuara dhe me këtë rast ka njoftuar se *“Arkeologu i kërkuar në këtë procedurë NUK e ka rolin e mbikëqyrësit nga aspekti ligjor e as nuk e ka të drejtën të aprovoj çfarëdo dokumenti në fushën e arkeologjisë, por roli i tij është përcjellja dhe koordinimi punimeve (nga aspekti arkeologjik) vazhdimisht në teren gjatë shpimeve të tokës që do të bëhen në trasenë e rrugës të specifikuar me këtë kontratë. Kështu që për çdo ARTEFAKT që eventualisht mund të haset gjatë shpimeve që do të bëhen atëherë arkeologu i OE-së duhet të informoj (sepse është ekspert i fushës) institucionet përkatëse që e kanë autoritetin ligjor dhe më pastaj janë ato institucione të cilët vendosin se si duhet të veprohet më tutje, siç janë: Instituti i Arkeologjisë së Kosovës, Departamenti për Trashëgimi Kulturorë i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Qendra rajonale për trashëgimi Kulturorë Prishtinë etj.*

Sqarim: *Përveç të tjerave me këtë kontratë duhet të hartohet edhe Elaborat Arkeologjik, prandaj në këtë punë duhet të jetë pjesëmarrja e ekspertëve të fushës, prandaj arkeologu i kërkuar duhet të jetë koordinatori i hartimit të këtij elaborati, normalisht elaborati duhet të bëhet duke bashkëpunuar me institucionet të cilat kanë autoritetin ligjor në Republikën e Kosovës. Kështu që autoriteti kontraktues e ka kërkuar minimumin (vetëm një arkeolog) e mundshëm me qëllim të zbatimit të kontratës nga pjesa e fushës së arkeologjisë, prandaj OE-ja patjetër në stafin e vetë duhet të ketë një arkeolog. Ndërsa përderisa arkeologu (OE-së) i kërkuar nga AK-ja nuk ka asnjë lloj vendimmarrje pa bashkëpunimin dhe aprovimin e institucioneve që kanë autoritet ligjorë dhe po ashtu nuk është as autoritet mbikëqyrës atëherë arkeologu i kërkuar nuk është në kundërshtim me ligjin në asnjë mënyrë, përderisa ai do të bashkëpunoj me autoritetet ligjore përkatëse”.*

Nga sqarimet e ofruara prej njësisë kërkuuese të Autoritetit Kontraktues rezulton se kriteri i kontestuar përmes pretendimit ankimor të parashtruesit është kriter i domosdoshëm i cili është i mundshëm, i ligjshëm dhe në shërbim të qëllimit të aktivitetit të prokurimit në përputhje me nenet 1, 7, 27 dhe 28 të LPP. Prandaj pretendimi i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 20.06.2023



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.